



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.95/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.95/2025 e datës 21.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datën 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në rrugë publike, konkretisht në rreth rrotullimin e rrugës "Ibrahim Rugova", në Istog.

Me këtë veprim kandidati dhe Subjekti Politik LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Si provë për pretendimet në ankesë, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit, në kundërshtim me LZP.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LDK, thuhet se kandidatët e subjektit në fjalë nuk kanë bërë shkeljen e dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse disa nga kandidatët për deputet nga

radhët e Subjektivit Politik LDK, dega në Istog, me rastin e vendosjes se materialeve reklamuese-postereve, posedojnë Pëlqim të përkohshëm për shfrytëzim të hapësirës publike, të lëshuar nga Komuna e Istogut — Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektivit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, në këtë rast Pëlqimin e leshur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Istogut, nr.11/351-1562/11, datë 20.01.2025, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, konkretisht në rreth rrotullimin e rrugës “Ibrahim Rugova”, në Istog, për vendosjen e posterit, vërtetoi se posteri i kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektivit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i vendosur nga Subjekti Politik LDK, nuk është në kundërshtim me rregullat zgjedhore ngase është vendosur me pëlqimin e drejtorisë përkatëse të Komunës së Istogut. Andaj vendosja e reklamës nga kandidati në fjalë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore dhe njëherit është në pajtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, konkretisht neni 5 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.95/2025 datë 23.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.